



Nr. Prot.043/B/20

VENDIM Nr. 1626
Për
Shqiptimin e Gjobës
për
Ndërmarrjen "CITY POSTA" SHPK

Në mbështetje të nenit 7 paragrafi 2.4, nenit 28 paragrafi 1 dhe paragrafi 5), nenit 55 paragrafi 2, nenit 58 paragrafi 1 dhe paragrafi 3.1) 3.3.2) të Ligjit Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare (*tutje; Ligji*); nenit 79, paragrafët 1), dhe 2), të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 12 paragrafi 4) dhe 5) i Rregullores Nr. 41 për Dhënin e Autorizimit të Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare dhe nenit 13, paragrafi 1), dhe 5), të Statutit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi i ARKEP-it, i përbërë nga:

- 1) z. Nijazi Ademaj Anëtar i Bordit
- 2) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 3) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit
- 4) z. Shqiprim Pula Anëtar i Bordit

në mbledhjen 54-të me radhë të mbajtur më datë 24 Qershor 2020, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe rekomandimit të Sektorit të Shërbimeve Postare (SSHP), nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Operatorit të shërbimeve postare: 'CITY POSTA' SHPK, me NUI: 810875099, i shqiptohet gjoba në shumën prej pesëqind (500.00) Euro, për shkak të mos dorëzimit të pasqyrave financiare të vitit paraprak.
- II. z. ERDIN KURTOLLI, si person përgjegjës i ndërmarrjes 'CITY POSTA' SHPK, i shqiptohet gjoba në shumën prej; dyqind (200.00) Euro, për shkak të mos dorëzimit të pasqyrave financiare të vitit paraprak.
- III. Gjobat e shqiptuara në pikën I dhe II të këtij vendimi duhet të ekzekutohen brenda afatit prej **pesëmbëdhjetë (15) ditëve** nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- IV. 'CITY POSTA' SHPK urdhërohen që brenda afatit prej **tridhjetë (30) ditëve**, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të dorëzojë pranë Autoritetit, Raportin e Pasqyrave Financiare të Audituarra për vitin 2019.

V. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Autoriteiti me datë 03 mars 2020 nëpërmjet e-mail, (SENT: Tue 3/3/2020 9:50 AM) ka njoftuara ndërmarrjen 'CITY POSTA' SHPK për obligimin e tyre për dorëzimin e pasqyrave të audituara financiare për vitin 2019

Si pasojë e COVID - 19 Autoriteti ka shtyer dy herë afatin e raportimit dhe për këtë ka njoftuar ndërmarrjen në fjalë me anë të e-mailit SENT: Mon 3/23/2020 5:26 PM dhe SEND: Tue 5/5/2020 12:51 PM.

Bazuar në konkluzionet e mbledhjes së Bordit të mbajtur me 24 qershor 2020, ARKEP me datën 25 qershor 2020 i ka dërguar vërejtjen përfundimtare 'CITY POSTA' SHPK (Ref. E-mail, SENT; Thu 6/25/2020 2:32 PM) duke i dhënë përsëri afat shtesë për dorëzimin e raportit financiar.

Edhe përkundër këtij afati shtesë ndërmarrja "CITY POSTA' SHPK nuk ka sjellë raportin e audituar financiar.

Duke pas parasysh faktet e paraqitura si më lart dhe dispozitat ligjore si në vijim:

Neni 7 paragrafi 2.4 i Ligjit përcakton që: Autoriteti mbikëqyrë, monitoron dhe inspekton veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve postare, dhe merr masa administrative, në rast të shkeljeve të dispozitave këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 28 paragrafi 5 i Ligjit përcakton që: Ofruesit e shërbimeve postare dorëzojnë në Autoritet një kopje të pasqyrave financiare të audituara të vitit paraprak, deri më datë 31 mars të vitit vijues kalendarik.

Pra, si pasojë e mosdorëzimit të raportit të audituar financiar, ndërmarrja në fjalë shkakton shkeljen edhe të një dispozite të Ligjit, respektivisht paragrafin 1 i këtij neni ku përcaktohet që: Ofruesit e shërbimit postar janë të detyruar të paguajnë pranë Autoritetit, pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të shërbimeve postare.

Neni 55 paragrafi 2 përcakton që: Nëse ofruesi i shërbimeve në fjalë nuk i rregullon parregullsitë brenda afatit kohor të përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni, Autoriteti duhet të ndërmarrë masa proporcionale me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë, përfshirë këtu edhe sanksionet ekonomike të specifikuar në nenin 58 të këtij ligji

Neni 58, paragrafi 1), i Ligjit përcakton që: Nëse ofruesit e shërbimeve postare dështojnë të jenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, Autoriteti me vendim të veçantë ka të drejtë të shqiptojë gjoba.

Neni 58 paragrafi 3.1 i Ligjit përcakton që: Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, ndërsa përbëjnë kundërvajtje në shërbimet postare dënohen me gjobë si më poshtë: nga pesëqind (500) Euro deri në njëzet mijë (20,000) Euro për shkeljet e kryera nga një person juridik

Kurse paragrafi 3.3.2. i këtij neni përcakton që: Autoriteti do të shqiptojë gjobë nga dyqind (200) Euro deri në katër mijë (4,000) Euro, për shkeljet e kryera nga një person fizik ose juridik, i cili nuk kryen detyrimet dhe pagesat ndaj Autoritetit, ashtu siç është parashikuar në nenin 28 të këtij ligji.

Poashtu, Rregullorja Nr. 41 për Dhënin e Autorizimit të Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare, neni 12, paragrafi 4), përcakton që: Të gjithë ofruesit e shërbimeve postare, të cilët operojnë nën kushtet e 'Autorizimit të Përgjithshëm', duhet të kryejnë të gjitha obligimet financiare ndaj Autoritetit, në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe Rregulloret e miratuara nga Autoriteti.

Ndërsa, paragrafi 5) i këtij neni, përcakton që: Nëse ofruesi i shërbimeve postare i cili ofron shërbime postare nuk vepron në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore, atëherë Autoriteti do të veprojë në përputhje me nenin 58, të Ligjit dhe rregullores të miratuar nga Autoriteti mbi sanksionet ekonomike.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit;

Prishtinë: 19/08/ 2020.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Shqiprim Pula

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatori i shërbimeve postare 'CITY POSTA' SHPK;
- Z. Erdin Kurtolli, Përfaqësues i ndërmarrjes;
- Sektorit të Shërbimit Postar ARKEP;
- Departamentit Ligjor, ARKEP;
- Administratës - Zyra e Financave, ARKEP;
- Arkivit të ARKEP.